



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1102/7 prot.

Tiranë, më 17.10.2023

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 1102/1, DATË 28.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. ARSEN STOJKU”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e z. Arsen Stojku, me nr. 2929 prot, datë 22.06.2021, nr. 2929/1 prot, datë 22.06.2021, nr. 2929/3 prot., datë 23.06.2021, nr. 2929/4 prot., datë 29.06.2021 dhe nr. 2929/5 prot., datë 04.10.2021, ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve A. M., me detyrë prokuror në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Shkodër, B.S. dhe H.S, me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Shkodër dhe me vendimin nr. 1102/1, datë 28.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara nga shtetasi z. Arsen Stojku”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Shkodër, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rr. “Sulejman Pasha”, P.124, shkalla 3, Ap. 43, Shkodër;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

